

Edelajda Cenaj – Çepa (1984). Filologe, specialiste e ndërveprimit kulturor në traditën e shkrimeve në Shqipëri në dy shekujt e fundit. Pedagoge në universitetin "Aleksandër Xuvani", Elbasan (www.uniel.edu.al). Anëtare e Akademisë së të Rinjve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (2017). Ka kryer shkollën e mesme "Zihni Magani", Peqin (2002). Mbaroi studimet në Universitetin e Elbasanit, Fakulteti i Shkencave Humane, dega gjuhë dhe letërsi (2006). Diplomohet në master shkencor në *trashëgimi kulturore*, pranë Universitetit të Elbasanit "A. Xhuvani" (2011). Më pas, fiton të drejtën për të ndjekur studimet doktorale në shkollën e doktoraturës pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike, Tiranë, drejtimi *letërsi*. Mbron disertacionin "*Lef Nosi filolog*" me vlerësimin "Shumë mirë", dhe merr gradën "Doktor i shkencave" (2015). Ka punuar në arsimin parauniversitar duke u vlerësuar me kualifikime "Shumë mirë". Që prej vitit (2011) punon si asistente pedagoge dhe lektore pranë universitetit të Elbasanit në lëndët: etnologji, bibliotekonomi dhe etnofolklor rom. Boton monografinë "*Lef Nosi filolog*", (Naimi, 2015), studim historiko-letrar, arkeografik dhe filologjik. Përgatit dhe boton si bashkautore librin "*Dritëro Agollit, libër kushtim në 85-vjetorin e lindjes*" (Grand Prind, 2017). Edelajda Cenaj – Çepa është pjesëmarrëse në më shumë se 20 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, pjesëmarrëse në *workshop*-in me temë "Urban Regeneration of European Cities", Piza, Itali (2010), si dhe ka publikuar artikuj shkencorë në disa revista, si: *Haemus*, "Kopshti letrar botuar prej Lef Nosit" (nr. 45/50, Bukuresht, 2014); *The Heritage*, "Kodikët e Shqipërisë. Impresione vizive. Estetika dhe etika e përsosur e tyre" dhe "Një fjalor në dorëshkrim nga Lef Nosi", (nr. 11, 12, 2013, 2014); *Anglisticum* "Travel literature, and images and mirages in the work of Lumo Skendo Zvicra" (nr. 5, 2016) etj.